



Përditësim për shtypin

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, më 16 janar, në vendime të ndara, Trupi Gjykses vazhdoi paraburgimin e Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Gjykatësit konstatuan për secilin prej të akuzuarve se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit. Gjykatësit konstatuan se pavarësisht nga faza e këtij procesi gjyqësor, lrimi i një të akuzuari që ka në zotërim informacion të ndjeshëm nuk do të ndihmonte në mbrojtjen efikase të dëshmitarëve dhe rikujtuan konstatimin e tyre të mëparshëm se rreziku i ndërhyrjes përfshin gjithashtu: (i) orvatjet për t'u hakmarrë ndaj dëshmitarëve që kanë dhënë dëshmi në këtë proces; (ii) orvatjet për t'i motivuar dëshmitarët të tërheqin dëshmitë e tyre; dhe (iii) orvatjet për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve në procese paralele.

Në secilin prej këtyre vendimeve, Trupi Gjykses konstatoi se rreziku i pengimit të procesit dhe i kryerjes së veprave penale të tjera mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të DHS-së. Në veçanti, gjykatësit vlerësuan se mekanizmat e incizimit në objektin e paraburgimit të DHS-së dhe personeli i Zyrës Administrative, marrë në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër rreziqeve që lidhen me format e komunikimit të pambikëqyrur dhe se masat në fuqi ofrojnë një mjedis të kontrolluar ku një shkelje e mundshme e konfidencialitetit mund të evidentohet dhe/ose parandalohet më lehtë.

Sipas ligjit, një i akuzuar mund të mbahet në paraburgim vetëm nëse gjykatësit konstatojnë se ekzistojnë rreziqe që e përligjin atë. Gjykatësit rishikojnë paraburgimin të paktën çdo dy muaj dhe vlerësojnë nëse vijon të jetë i nevojshëm për të trajtuar këto rreziqe.

Kushtet e paraburgimit në objektin e paraburgimit të DHS-së monitorohen në mënyrë të pavarur nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq dhe nga Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Të gjithë të paraburgosurit kanë dhjetë ditë vizitash personale në çdo periudhë prej 30 ditësh, përfshirë vizita me prani fizike dhe përmes videolidhjes, thirrje telefonike dhe letërkëmbim të rregullt, në përgjithësi gjatë gjithë muajit. Gjithashtu, të gjithë të paraburgosurit pranojnë vizita të rregullta familjare, nga bashkëshortet dhe fëmijët, të cilat bëhen jashtë rrezes së shikimit, dëgjimit, dhe mbikëqyrjes së oficerëve të paraburgimit.

Në çështjen e Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit në lidhje me pretendimet për ndikim të paligjshëm ndaj dëshmitarëve, gjykatësi i çështjes miratoi një kërkesë të ZPS-së për shtimin e materialeve në listën e saj të provave materiale dhe nxjerrjen zyrtare të këtyre materialeve Mbrojtjes më 19 janar 2026. Në materialet shtesë përfshihen materiale që ZPS-ja ka marrë gjatë muajit të fundit nga një institut dhe një kompani forenzike. Të njëjtën ditë, gjykatësi miratoi një kërkesë të përbashkët





të Mbrojtjes për shtimin e numrit të fjalëve për përgjigjen e tyre ndaj mocionit të ZPS-së për pranim të provave.

Më 20 janar, gjykatësi i çështjes miratoi një kërkesë të Prokurorisë për pranimin si prova të intervistës së z. Kilaj dhënë prokurorëve në kohën e kontrollimit dhe sekuestrimit në vendbanimin e tij, bashkë me provat materiale që lidhen me intervistën. Në kohën e intervistës, z. Kilaj hoqi dorë nga e drejta e tij për të heshtur dhe nga e drejta për të pasur avokat të pranishëm gjatë intervistës. Gjykatësi konstatoi se përpara intervistës, ZPS-ja i kishte komunikuar z. Kilaj, gojarisht dhe me shkrim në shqip, të gjitha të drejtat e tij si i dyshuar sipas nenit 38(3) të Ligjit të DHSK-së, dhe se z. Kilaj kishte konfirmuar përmes vënies së nënshkrimit se i kuptonte këto të drejta. Z. Kilaj u informua gjithashtu se mund të tërhiqej nga heqja dorë e të drejtave në çdo kohë dhe të ndryshonte mendje lidhur me praninë e avokatit.

Sipas ligjit, prokurorët ishin gjithashtu të detyruar të njoftonin z. Kilaj se ishte i dyshuar për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Mbrojtja e kundërshtoi pranimin e intervistës me pretendimin se z. Kilaj nuk ishte informuar mjaftueshëm në hollësi për veprat penale për të cilat hetohej. Bazuar në incizimin e intervistës, gjykatësi konstatoi se intervistuesit ia kishin bërë të qartë z. Kilaj që në fillim se ekzistonin arsye për të besuar se ai kishte kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e gjykatës, se ZPS-ja hetonte krime ndërkombëtare dhe krime të lidhura me pengimin e drejtësisë, dhe se çdo deklaratë e dhënë nga ai mund të përdorej kundër tij në gjykatë.

Duke iu referuar jurisprudencës së tribunalëve ndërkombëtarë dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatësi përcaktoi se “hetuesit paraqitën hapur në fillim të intervistës ‘arsyet e tyre për të besuar’ se z. Kilaj mund të ketë marrë pjesë në një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së”, se, “dokumentet që iu paraqitën z. Kilaj përmbanin jo vetëm llojin e veprave penale për të cilat ai dyshohej, por edhe llojin e informacionit për të cilin bëhej fjalë,” dhe se “asgjë në këto shkëmbime nuk lë të mendohet se heqja dorë nga të drejtat, e shprehur në fillim të intervistës, ishte bërë pa qenë plotësisht i informuar...”

Në lajme të tjera, këtë javë ekipi i Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim gjendet në Kosovë ku po zhvillon aktivitete për të informuar grupe studentësh në Prishtinë lidhur me mandatin dhe proceset në gjykatë, për të dëgjuar mendimet e tyre, dhe për t’u përgjigjur pyetjeve të tyre.

Prej vitit 2028, DHSK-ja zhvillon rregullisht aktivitete në gjithë Kosovën me studentë, gazetarë dhe publikun, si pjesë e Programit për komunikim dhe ndërgjegjësim, ku jep informacion publik lidhur me gjykatën, dëgjon komentet e njerëzve, dhe u përgjigjet pyetjeve të tyre.

